



Më datë 10.06.2026, Komuna e Novobërdës publikon:

Shpallje publike për dhënien me qira të pishinave të hapura në Kufcë të Epërme përmes grumbullimit të ofertave me shkrim

- I. **Lënda e dhënies në shfrytëzim:**
Hapësira e pishinave të hapura në Kufcë të Epërme, parcelat kadastrale nr. 02667-0, 02384-2, 02382-0 dhe një pjesë e parcelës 02666-1, në pronësi të Shkollës Filllore "P.P. Njegos", Komuna e Novobërdës.
- II. **Destinimi i hapësirës që jepet në shfrytëzim:**
Mbajtja e stërvitjeve të klubeve të notit, aktivitete sportive dhe rekreative të klubeve sportive (të notit), aktivitete hoteliere, rekreative dhe sportive, si dhe shërbime komerciale për shfrytëzimin e hapësirës.
- III. **Periudha e dhënies në shfrytëzim:**
Viti 2026, për një periudhë prej 3 muajsh nga data e nënshkrimit të kontratës (periudha qershor–shtator).

Kushtet dhe kriteret për paraqitjen e ofertës

- Certifikatë për veprimtarinë e regjistruar;
- Kapacitetet profesionale dhe të personelit për menaxhimin e kompleksit;
- Dokumentacion tjetër i nevojshëm si:
- Vërtetim nga Gjykata se personi përgjegjës dhe personi juridik nuk janë dënuar ose nuk ndiqen penalisht për vepra penale;
- Vërtetim se personi përgjegjës dhe personi juridik nuk kanë borxhe financiare ndaj Administratës Tatimore të Kosovës;
- Dëshmi për posedimin e të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë.

Këto dokumente duhet të dorëzohen pas vlerësimit dhe përzgjedhjes së aplikuesit për menaxhimin e pishinave të hapura.

Kushtet shëndetësore dhe sanitare

- Mirëmbajtja e higjienës së pishinave (pastrim dhe dezinfektim i rregullt);
- Kontrolli i cilësisë së ujit (analiza të rregullta të përbërjes kimike dhe parametrave mikrobiologjikë);
- Prania e detyrueshme e shpëtimtarëve.

Standardet e sigurisë

- Pajisja e pishinave me pajisje sigurie (jelekë shpëtimi, rripa shpëtimi, kuti të ndihmës së parë);
- Shënimi i thellësisë së pishinave dhe vendosja e paralajmërimeve për rreziqet;
- Mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve dhe infrastrukturës (shkallët, ulëset, dushet).

Kushtet financiare

- Bartja e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe riparimeve eventuale gjatë periudhës së qirasë.

Kushtet teknike

- Mirëmbajtja e rregullt e filtrave, pompave dhe sistemeve të tjera teknike.

Afati për dorëzimin e ofertave është **8 ditë**, nga **10.06.2026 deri më 19.06.2026 në ora 16:00**.

Aplikimet dorëzohen në formë elektronike në adresën zyrtare elektronike të Komunës: **info.novoberde@rks-gov.net**, me titullin e qartë: **"Shpallje publike për dhënien me qira të pishinave të hapura në Kufcë të Epërme përmes grumbullimit të ofertave me shkrim"**.

Hapja publike e ofertave do të bëhet më **22.06.2026 në ora 10:00** në objektin e komunës. Pas kësaj fillon afati për ankesa, i cili zgjat **5 ditë pune** nga dita e hapjes së ofertave dhe publikimit të rezultateve.

Ofertat e vonuara dhe të paplota nuk do të merren në shqyrtim.

Procedura e dhënies me qira përmes ofertave me shkrim konsiderohet e suksesshme nëse është pranuar të paktën një ofertë e rregullt dhe e dorëzuar me kohë.

Përparësi për marrjen me qira të hapësirës do të ketë ofertuesi që ofron çmimin më të lartë të qirasë.

Nëse në shpallje paraqiten dy ose më shumë pjesëmarrës dhe ofrojnë të njëjtën shumë, përparësi do të ketë pjesëmarrësi që e ka dorëzuar ofertën më herët.

Komisioni do t'i njoftojë të gjithë ofertuesit me shkrim për rezultatet e shpalljes.

Kryetari i komunës së Novobërdës

Z. Saša Milošević

